



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR DEKRETIN NR. 8851, DATË 19.12.2014, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 154/2014 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 26 janar 2015, shqyrtoi dekretin nr. 8851, datë 19.12.2014, të Presidentit të Republikës, për kthimin e ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në mbledhjen e Komisionit ishte i pranishëm, për të dhënë shpjegimet e nevojshme, Drejtori i Drejtorisë Juridike në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Ana procedurale.

Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 85, përcakton: “Presidenti i Republikës ka të drejtë të kthejë ligjin për shqyrtim vetëm një herë. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit”.

Rregullorja e Kuvendit, në nenin 86, përcakton: “Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.

Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.”.

Mbi përmbajtjen e dekretit.

Me dekretin nr. 8851, datë 19.12.2014, Presidenti i Republikës ka kthyer për rishqyrtim, në Kuvend, ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Arsyeja e këtij akti është se neni 23 i ligjit, sipas dekretit, bie ndesh me Kushtetutën dhe me vendimin 212/2002 të Gjykatës Kushtetuese.

Në nenin 23 të ligjit nr.154/2014 përcaktohen rastet e mbarimit të mandatit dhe të shkarkimit të Kryetarit të KLSH-së, si më poshtë:

Mbarimi i mandatit dhe shkarkimi

1. Mandati i Kryetarit të KLSH-së mbaron kur:

- a) mbaron afati shtatëvjeçar i qëndrimit në detyrë;
- b) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- c) nuk paraqitet në detyrë për shkaqe të paarsyeshme;
- ç) jep dorëheqjen;
- d) deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;
- dh) mbush moshën e pensionit;
- e) vdes.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të shkarkohet nga Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës, kur:

- a) shkel Kushtetutën ose shkel rëndë ligjin gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
- b) cilësohet nga gjykata me vendim të formës së prerë si i paaftë për të kryer detyrat e tij;
- c) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi,
- ç) kryen akte ose sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij.
- d) zbulohen raste të papajtueshmërisë së funksionit të tij.

3. Në rast se vendi i kryetarit mbetet vakant, Presidenti, brenda 15 ditëve, i propozon Kuvendit kandidaturën e re. Kuvendi zgjedh Kryetarin e KLSH-së brenda 15 ditëve nga paraqitja e kandidaturës.”

Rastet e mbarimit të mandatit dhe të shkarkimit të Kryetarit të KLSH-së, të përcaktuara në këtë nen, janë të njejta me ato të përcaktuara në nenin 14 të ligjit nr.8270, datë 13.12.1997 “Për Kontrollin e Lartët të Shtetit”, të ndryshuar, i cili është shfuqizuar me vendimin nr. 212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese.

Argumenti i përdorur nga Gjykata Kushtetuese për shfuqizimin e këtij neni është se në Kushtetutë nuk parashikohen rastet e shkarkimit apo të mbarimit para kohe të mandatit për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Parashikimi në ligjin për Kontrollin e Lartë të Shtetit i rasteve të shkarkimit të Kryetarit të këtij institucioni, vendos kufizime dhe kapërcen kufijtë kushtetues. Për të shmangur këto kufizime, Kushtetuta nuk ka përcaktuar rastet e shkarkimit të mandatit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Këto raste vlerësohen nga Presidenti, i cili paraqet propozimin për shkarkimin e Kryetarit të KLSH, si dhe Kuvendi, i cili shqyrton propozimin dhe vendos për miratimin ose jo të tij.¹

Lidhur me institucionet e tjera, kushtetuta nuk parashikon rastet e mbarimit të mandatit apo të shkarkimit për Avokatin e Popullit dhe anëtarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa i parashikon ato për Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarin e Gjykatës së Lartë dhe Prokurorin e Përgjithshëm.

VLERËSIMI I KOMISIONIT.

Mendimi i shumicës.

¹ Në nenin 162, pika 2 të Kushtetutës përcaktohet se:

“2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhje.”.

Shumica e anëtarëve të Komisionit është e mendimit se:

Së pari, referuar nenit 162, pika 2 të Kushtetutës, shkarkimi i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit bëhet nga Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës. Ky atribut kushtetues nuk është cenuar në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Kuvendi nuk mund ta shkarkojë Kryetarin e KLSH-së pa një propozim të Presidentit të Republikës.

Së dyti, duke iu referuar nenit 165, pika 2 të Kushtetutës, funksioni i Kryetarit të KLSH-së njësohet me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Në nenin 140 të Kushtetutës përcaktohet se:

“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të shkarkohet nga Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike dhe për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.”.

Mbështetur në këto dispozita kushtetuese, ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” ka përcaktuar rastet e shkarkimit të Kryetarit të KLSH-së, për analogji me ato të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Së treti, projektligji është diskutuar gjatë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, si dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në disa mbledhje të tyre, të zhvilluara gjatë periudhës mars-tetor 2014. Ai ka gjetur dakordësinë e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë gjithë fazës së shqyrtimit të tij. Shumë amendamente, përfshirë edhe nenin 23 të projektligjit, janë mbështetur në propozimet e Kryetarit të KLSH-së. Ato kanë synuar zbatimin e kërkesave të Raporteve të Progresit të Bashkimit Europian për përafrimin e ligjit për KLSH-në me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), Deklaratën e Limës, Deklaratën e Meksikës, si dhe praktikën e përparuar të vendeve të tjera, si Çekia, Hungaria, Kroacia e Maqedonia.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të projektligjit është marrë konsulenca e ekspertëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) në Komisionin Europian, si dhe të Programit SIGMA të BE-së dhe OECD-së për mbështetje në qeverisje dhe menaxhim. Komisioni mori një kërkesë nga SIGMA për të përcaktuar qartësisht arsyet e shkarkimit të Kryetarit të KLSH-së. Procesi i konsultimit me të gjitha këto palë kërkoi kohën e nevojshme dhe, në përfundim, sugjerimet e tyre u pasqyruan në projektligj.

Për të gjitha këto arsye, shumica e deputetëve e kundërshtoi dekretin e Presidentit të Republikës.

Mendimi i pakicës.

Deputetët e opozitës u shprehën dakord me dekretin e Presidentit të Republikës. Ata mbështetën argumentet e paraqitura në dekret lidhur me mospërcaktimin në Kushtetutë të rasteve të shkarkimit të Kryetarit të KLSH-së dhe rrjedhimisht, detyrimin për mospërfshirjen e tyre në ligj.

Përfundim.

Komisioni nuk e miratoi dekretin e Presidentit të Republikës me shumicën e votave të anëtarëve të tij.

RELATORJA

Blerina GJYLAMETI

Tiranë, 26.01.2015

KRYETARI

Erion BRAÇE